



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:067211  
Datë: 15.03.2024  
Numri i dokumentit: 05456279

E.nr.682/23

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil,** me gjyqtarin Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani duke vendosur në lëndën e përmbartimit të kreditorës Sh.K. nga Ferizaj të cilët i përfaqëson Av. Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Spitali i Përgjithshëm - Ferizaj, për pagesën e pagave jubilarë dhe shpenzimet e procedurës, më datë: 01/09/2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbartimore në lëndën E.nr.682/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.682/23, të datës 15/05/2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve kundër debitorit Spitali i përgjithshëm - Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të Aktgjykimit: 2020:067211, të datës 30/09/2020.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 19/09/2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,281.62euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorës.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

E.nr.682/23, më datë 15.03.2024

**GJYQTARI**  
Faton Ajvazi